

Të nderuar studentë,

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar të FAU me Universitetet partnere Gjermane ju paraqesim thirrjen për shprehje interesi për pjesëmarrje në projektin:

“Resource Efficient Urban Regeneration of Informal Settlements in Tirana, Albania - Solutions for Ongoing Transformation / Rigjenerimi efikas i vendbanimeve urbane informale në Tiranë, Shqipëri - Zgjidhje për transformimin e vazhdueshëm”, i cili është hartuar në kuadër të programit të fondeve të dhëna nga DAAD (Shërbimi i Shkëmbimit të Akademikëve Gjermanë) lidhur me projektin “University dialogue with the Western Balkans”.

Pjesëmarrës në këtë projekt, për vitin akademik 2021-2022, janë:

- **Universiteti HafenCity University Hamburg,**
Drejtues projekti: Prof. Dr. Ing. Wolfgang Dickhaut

dhe

- **Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës,**
Drejtues projekti: Prof. Dr. Florian Nepravishta

Aktiviteti didaktik mbështetet në zhvillimin e një projekti të përbashkët, në formën e workshopit, midis dy universiteteve të sipërpërmendura, duke synuar shkëmbimin e informacioneve, dhe transferimin e njohurive. Workshopet do të zhvillohen në muajin Nentor 2021 në të dy vendet, 1 javë në Tiranë, ku do të analizohet dhe zona e marrë në studim mbi të cilën do të hartohet projekti nga të dy Fakultetet, dhe 1 javë në Hamburg, ku do të shihen raste transformimi urban të konsideruara si të suksesshme. Në përfundim do të ballafaqohen dhe eksopozohen projektet e të dy universiteteve, me synim hartimin e një publikimi të përbashkët.

Në këtë projekt **do të përzgjidhen 10 studentë nga MSHA Urbanist, pjesëmarrës në lëndën “Projektim Urbanistik 3 – Rivitalizimi Urban”, në bashkëpunim me 10 studentë do të përzgjidhen nga MSHA Arkitekt, pjesëmarrës në lëndën “Adaptim Arkitektonik”.**

Projekti i realizuar do të ekuivalentohet me projektin e kursit që zhvillohet në këto lëndë. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe dieta ditore (për mensën universitare), për udhëtimin në Gjermani do të mbulohen nga fondet e DAAD.

Përzgjedhja e studenteve do të bazohet mbi kriteret e mëposhtme:

- mesatarja e përgjithshme e katër viteve;
- mesatarja e lëndëve të Studiove të projektimit arkitekturë dhe urbanistikë;
- letër motivimi, ku argumentoni përse jeni të interesuar të jeni pjesëmarrës në këtë projekt të përbashkët;
- aftësitë tuaja në komunikim dhe shkrim të gjuhës Angleze, e cila dokumentohet me çertifikata që mund të keni në zotërim.

Për situatën në të cilën gjendemi, për momentin lëvizja duket e mundur Gjermani-Shqipëri. Vetëm se, do të pranohen studentët të cilët do të mund të dokumentojnë vaksinimin me dy dozat, me vaksina të njohura nga shteti Gjerman:

https://www.pei.de/EN/newsroom/dossier/coronavirus/coronavirus-content.html;jsessionid=C15BD927D4FEA5DB6441519A06B57005.intranet242?nn=164146&cms_pos=2

Këto të dhëna, për si ndryshon situata, mund të jenë subjekt ndryshimi në vijim.

Nëse për arsye madhore, nuk do të mundësohet lëvizja Shqipëri-Gjermani, do të marrim masa ta zhvillojmë këtë aktivitet ONLINE!

Ju lutem, shprehni interesin tuaj **brenda datës 04 TETOR 2021**, duke dorëzuar me email në adresat juljan.veleshnja@fau.edu.al dhe florian.nepravishta@fau.edu.al **dokumentat e skanuara:**

- **letrën e motivimit;**
- **listën e notave;**
- **dëshmi të gjuhës angleze;**
- **dëshmi vaksinimi COVID**

(për ata që e kanë kryer deri në datën e aplikimit, të tjerët do duhet të marrin masat të kryejnë 2 dozat në harkun kohor që lejon udhëtimin)

Në përfundim të dorëzimit të dokumentave, do të shqyrtohen aplikimet tuaja, do t'ju komunikohet lista e studentëve të përzgjedhur.

Me respekt,

Pedagogët e lëndëve